



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 24, paragrafit 1 dhe 2, lidhur me nenin 25, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”, neneve 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 23.07.2019, miraton këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

Neni 1

1. **MIRATOHET;** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale me pronën e paluajtshme private për interes publik.
2. Pronat e paluajtshme komunale të cilat i **jepen** në emër të këmbimit Avdi (Salih) Elshani nga Suhareka, janë: **1. Parcela** kadastrale me **P-72116046-01073-8** sipas certifikatës së pronës Nr.1474-2 e datës 23.07.2019, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata/Afër Stacionit” e evidentuar në emër të Kuvendit Komunal në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **47m²**, **2. Parcela** kadastrale me **P-72116046-01073-6** sipas certifikatës së pronës Nr.1474-2 e datës 23.07.2019, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata/Afër Stacionit” e evidentuar në emër të Kuvendit Komunal në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **5m²**, **3. Pjesa e parcelës** kadastrale me **P-72116046-01073-5** sipas certifikatës së pronës Nr.1474-2 e datës 23.07.2019, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata/Afër Stacionit” e evidentuar në emër të Kuvendit Komunal në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **107m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim jepen **51m²** dhe **4. Pjesa e parcelës** kadastrale me **P-72116046-01070-15** sipas certifikatës së pronës Nr.1474-2 e datës 23.07.2019, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata/Afër Stacionit” e evidentuar bashkpronare me pjesen ideale me 1/11 në emër të Kuvendit Komunal në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **85m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim jepet 1/11 përkatsisht **8m²**, pjesa ideale e Komunës.
3. **Ndërsa** prona e paluajtshme private e cila merret në emër të këmbimit është; Pjesa e parcelës kadastrale me **P-72116046-01073-1** sipas certifikatës së pronës Nr.1474-2 e datës 23.07.2019, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata/Afër Stacionit” e evidentuar në emër të Avdi (Salih) Elshani nga Suhareka, me sipërfaqe të përgjithshme prej **585m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme këmbimi bëhet për **116m²**.

Neni 2

Këmbimi i pronës se paluajtshme është bërë pasi që nuk ekziston parcelë tjetër komunale të përshtatshme për realizimin e Planit zhvillimor komunal në Suharekë, konkretisht zgjerimin e rrugës "Brigada 123" në qytetin e Suharekës.

Neni 3

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, që të zhvilloj të gjitha procedurat ligjore, konform dispozitave të nenit 25, të Ligjit Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/2019.

Neni 4

Prona e këmbyer nga personi Juridik dhe personat fizik të cekur në neni 1, të këtij vendim mundet të bartet në librat kadastral, pas nxjerrjes së akt-vlerësimit nga zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme nga Departamenti i tatimit në pronë i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Financave në Prishtinë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër e Komunës së Suharekës.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-016-48760
Më datë 23.07.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI